



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/915
Datë: 17/12/2020

Këshilli Drejtues në vazhdimin e mbledhjes së datës 10.12.2020, të mbajtur me datë 17.12.2020, mori vendim që të shpall:

K O N K U R S

Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2020/2021

I

Kushtet e përgjithshme

1. Bursa universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve themelore (baçelor).
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës;
 - 2.2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
 - 2.3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 - 2.4. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2019/20;
 - 2.5. Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku 9.00 (nëntë pikë zero).
3. Përjashtimisht nga pika 2.5, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë, të Fakultetit Arkitekturës, të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të Fakultetit Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Matematikës dhe Departamenti i Fizikës, mund të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ulët, por jo më pak se **8 (tetë)**.
4. Studentët të cilët në vitin akademik 2019/2020 kanë pasur statusin e studentit me korrespondencë, nuk kanë të drejtë aplikimi për bursë universitare për vitin akademik 2020/2021.

II

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - 1.1. Kërkesën për aplikim;
 - 1.2. Vërtetimin për statusin e studentit dhe dëshminë për regjistrim të vitit akademik 2020/21;
 - 1.3. Transkriptin e notave dhe
 - 1.4. Fletëparaqitjen (shkarkohet nga ueb-faqja e universitetit).

2. Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në zyrën e shërbimit të studentëve në fakultetet përkatëse:
 - 2.1. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
 - 2.2. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e sipërshënuara, shërbimi i studentëve në njësitë akademike përkatëse nuk do t'iu lëshojë Fletëparaqitjen e cila ua mundëson aplikimin për bursë.
 - 2.3. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësive akademike.
3. Bursat universitare për vitin akademik 2020/2021 për rezultatet e arritura të vitit akademik 2019/2020 do t'u ndahen studentëve të nivelit baçelor, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, ndërsa lartësia e bursës është përcaktuar me vendimin nr.3/914, të datës 17.12.2020.

III

Afati i aplikimit

1. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, përkatësisht prej **datës 21.12.2020 deri me datë 10.01.2021 në orën 15:30.**

IV

Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
3. Ankesat duhet të dorëzohen në zyrën nr.19, në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.

V

Publikimi

4. Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve si dhe në ueb-faqen e Universitetit: www.uni-pr.edu.

